



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 06/2025

I Mbajtur në takimin e VI-të të rregullt të KK-së me datën 30.06.2025, në sallën e e takimeve në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit: kryetar i komunës, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VI-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së.
2. Miratimi i rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së.
4. Propozim-Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028.
5. Propozim-Vendim për shpalljen interes i përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale: 555-0 z.k.Balaj, pronë private.
6. Pyetje dhe kërkesa dhe
7. Të ndryshme.

Kryesuesi theksoi se në KPF kemi miratu edhe këto pika, propozim vendim për pezullimin e vendimit me numër 01.38 i datës 30.04.2025, po ashtu propozim vendim për pezullimin e vendimit 01.34 po ashtu i datës 30.04.2025, po ashtu e kemi edhe nivelizimin e pagave për aksionaret në ndërmarrjen publike pasi është miratu Ligji për pagën minimale dhe s'paku me atë pagë propozojmë që të bëhet, a ka dikush rreth rendit të ditës.

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se propozoj që pika e fundit të hjeket, pasi si e dini edhe ju aksionarët nuk vijnë asnjëherë këtu për t'i raportu, qe 4 vite i kemi zgjedhë, si ka mundësi t'ia rrisim pagat kur asniherë nuk vijnë këtu.

Faik Selmani propozoj që të bëhet vazhdimi i mandatit për komisionin e emërimit të rrugëve pasi tash i del kontrata dhe është i domosdoshëm që të vazhdohet.

Flamur Istrefi pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi se e mbështës propozimin e kolegut Brahim, pasi të njëjtit e kanë neglizhuar në vazhdimësi kuvendin, madje edhe raportet i bijën me vonesë dhe asnjëherë nuk vijnë këtu për t'i paraqitur ato raporte.

Ibrahim Hyseni pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se unë mendoj që kjo pikë duhet të jetë, pasi ligji na obligon që ta bëjmë këtë sen, nëse dojmë mi pa i ftojme këtu dhe nëse s'përgjigjen ka forma tjera, spo tham që jem t'i pa këtu, po ligji na obligon, unë e mbështes këtë pikë.

Flamur Istrefi, ashtu si shumica e pikave po kapërcjenë pa material edhe kjo pikë po vjen pa material ne nuk dimë pse po ndodhë ky rishqyrtim, e tash pezullim kisha kërkun, që s'paku shefat e grupave të kemi material se kështu spo dimë çka me votu.

Kryesuesi e nxjerr rendin e ditës të prezentuar në KPF dhe kaloi me 23 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

E patëm një propozim për anulimin e pikës për aksionar, kush është që të hjeket nga rendi ditës, 9 janë për, kundër janë 21, kalon për në rend dite.

Dhe e kemi një pikë, për komision për vazhdimin e mandatit, nuk e shohë të arsyeshme të futet sot, megjithatë kush është për, 23 vota janë për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi pyeti a ka dikush rreth procesverbalit, pasi që ska kush është për miratimin e tij 30 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi theksoi se sa i përket pikës së 4-të KAB-it ia japim fjalën Kryetarit të Komunës z.Agim Aliu i cili theksoi:

I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës,

Drejtorë të drejtorive komunale,

Të respektuar anëtarë të Kuvendit,

Shoqëri civile, media,

Zonja dhe zotërinj!

Tashmë si në çdo qershor, nisim konsultën publike me qytetarët, për të vënë themelet e kornizës investimore, për të vendosur projektet së cilat synojmë t'i realizojmë për vitet pasrendëse, përmes Kornizës Afatmesme Buxhetore, dokument ky që ka gjurmën e fjalën e qytetarëve për të vendosur për nevojat e kërkesat e tyre, për vitet që na presin.

Sot të nderuar anëtarë të Kuvendit, diskutojmë Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028, një dokument ky që paraqet bazën themeltare të planifikimeve të hershme të investimeve publike, shpërndarë ndër vite, për të përmbushur synimet e qytetarëve, synimet tona, për cilësi të reja jetese, mirëqenie, zhvillim e perspektivë për të ardhmen e Ferizajt e ferizajasve.

Dokumenti që sot ndodhet para jush, për të marr bekimin e vulën tuaj, është produkt i debatit publik, i zërit të qytetarëve artikuluar në konsultën e dëgjuesat publike që kemi organizuar, është vazhdimësia e vizionit për të pandalshmin hap të zhvillimit të Ferizajt, për vitet që e presin.

Dhjetëra projektet që përbëjnë këtë kornizë investimore, janë nistoret e zhvillimit të Ferizajt, duke i dhënë kahje të reja, duke hapur kapituj të ri ecjeje përpara.

Duke çmuar e vlerësuar secilin mendim të qytetarëve, propozimet që ngërthehen në këtë dokument, reflektojnë qartësisht e tërësisht, nevojat që ferizajasit kanë për projekte zhvillimi, që jo vetëm sanojnë një gjendje përkohësisht, por i japin hove me ritme të pandalshme, zhvillimit të gjithë Komunës sonë.

Zonja dhe zotërinj!

Ferizaj ynë ka herë është prijëtar e model i qeverisjes, me shembujt më kuptimplotë sesi ecet përpara me ritme të shpejta, sesi transformimi nuk është një fjalë boshe, por vepër reale, e prekshme, e matshme. Kemi dhënë provat e dëshmitë gjatë gjithë qeverisjes sonë, me energjinë e pashtershme, vizionin e qartë për t'i dhënë Ferizajt vepra identitare, gjurmë që i mbeten përjetësisht trupit të Ferizajt, duke përkthyer besimin e pamatshëm e të gjithanshëm të qytetarëve në jetë më të mirë për qytetarët.

Kjo është sigla e punës sonë, ky është Ferizaj – mishërimi i investimit të çdoditshëm, të çdo çastshëm të energjisë sonë, dijeve të skuadrës sonë qeverisëse, guxim të marr përsipër transformimin e 345 Km².

Edhe në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 pasqyrohet sheshazi kjo qasje transformuese, ky vizion zhvillimor, me projekte të rëndësishme të lartë publike, më zërin e qytetarëve formuluar si emërtime projektesh, që vijojnë pandalshëm, rrugën që nisëm në dhjetorin e 2017-tës për Ferizajn që duam.

Ferizaj nuk ndalet, ferizajasit duan zhvillim.

Ne kemi rritur standardin e punëve publike në gjithë Republikën, kemi dhënë dëshmitë se asgjë nuk është e pamundur, me besimin e qytetarëve, me mirëqeverisjen. Atë e thotë qartë çdo zë i ferizajasve e përtej qytetit tonë.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Zonja dhe zotërinj!

Në planifikimin buxhetor të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028 për vitin 2025 në kategorinë e investimeve kapitale janë buxhetuar 12,328,834.32€ kurse për vitin pasues 2026, janë planifikuar 13,230,000.00€, gjersa në vlerësimet e hershme buxhetore për vitet 2027 dhe 2028 janë planifikuar 14,859,000.00€ përkatësisht 16,615,000.00€ në kategorinë e investimeve kapitale.

Ferizaj çdo ditë po transformon fizionominë e tij me vepra publike, me ide të vëna në zbatim, që po pasurojnë vlerat e Ferizajt, po i japin Ferizajt atë që meritonte prej dekadash. Edhe në këtë përmbledhje të planifikimit të investimeve tona për vitet që na presin, reflektohet kjo bindje, këto ide, këto nisma e projekte që vazhdojnë rrugën tonë të punës për transformimin e Ferizajt.

Projektet e gjelbëra, janë boshti i platformës sonë qeverisëse mbi të cilën morëm besimin e jashtëzakonshëm të qytetarëve. Ne po vijojmë angazhimet, punën e çdoditshme, për t'i dhënë Ferizajt dy masive të reja të gjelbëra, Parkun në Kodrën e Sherretëve – ku për pak muaj, përurojmë transformimin e rivitalizimin e tërësishëm të gjithë zonës, me ballkonin panoramik unik në Kosovë e standardin e ri që po vendosim me punën për rregullimin e parqeve.

Po kështu, Parku i Lirisë, po zgjeron trupin e tij të gjelbër, me shtigjet e reja, me hapësirat pushuese e rekreative, me amfiteatrin që po ndërtojmë, investime këto që shumëfishojnë vlerën e përdorimin e parkut nga ferizajasit e të tjerët.

Përkushtimi ynë për të gjelbrën, shprehet edhe në rregullimin e parqeve të reja në qytet e fshatra, ku tashmë kemi nisur punimet për rregullimin e Parkut tek ish lokacioni i KRM “Pastërtia” dhe shumë shpejt, nisim edhe rregullimin e Parkut tek ish lokacioni i Stacionit të Autobusëve në Ferizaj – duke i shtuar kështu ferizajasve edhe dy parqe të reja të jashtëzakonshme në zemër të qytetit.

Në këtë mes, kemi edhe projektin e rregullimit të parkut me gjithë infrastrukturën përcjellëse në fshatin Varosh.

Ditë më parë, përruam Parkun në rrugën “Sali Çeku”, një hapësirë që nga një rrip toke, u shndërrua në model për parqe dedikuar komunitetit të lagjes, pa lënë anash edhe parqet e shumta që rregulluam krahas rregullimit të oborreve të shkollave si në qytet e në fshatra, nisma këto që pandërprerë po vazhdojnë e do të vazhdojnë edhe në vitet pasrendëse.

Në këtë kuadër, punën tonë e vazhduam edhe me rregullimet në kryqëzimet rrugore, duke i shndërruar tërësisht ato, si në rrugën “Driton Islami”, pa lënë anash edhe përpjekjen tonë të përditshme për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta si dhe rregullimet e nevojshme skaj lumenjve, si në shetitoren rreth shtratit të lumit nga Ura e Dudit deri tek Ura e Islamit.

Në këtë fushë, në këtë dokument kemi planifikimin buxhetor edhe për rregullimin e parkut në Prelez si dhe ndërtimin e fushës sportive në Surqinë dhe Tërrn.

Një tjetër projekt me peshë të jashtëzakonshme për qytetin e qytetarët është edhe Tregu i Gjelbër, për të cilën po investojmë energjinë tonë për ta jetësuar këtë projekt me partneritet, që i jep Ferizajt edhe një aset të çmueshëm të jetës së tij publike, veprimtarive ekonomike e tregtare që zhvillohen në qytetin tonë.

Sa i përket fushës së infrastrukturës, projekteve ku Ferizaj bën dallimin e qartë me të gjitha qendrat e tjera, për qasjen transformuese, artin e funksionalitetin që zbaton përmes këtyre projekteve, na ndajnë edhe pak ditë nga përrurimi i një tjetër veprë të jashtëzakonshme infrastrukture, nënkallimit për vetura dhe këmbësorë tek Stacioni Policor në Ferizaj, vepër kjo që transformon gjithë zonën urbane, duke i dhënë dinamika zhvillimi çdo arterie rrugore të Ferizajt.

Po kështu, dimension të ri zhvillimi Ferizajt i japin edhe projeksioni ynë për rikonstruktimin e tërësishëm të rrugës “12 Qershor” si dhe rikonstruktimi i rrugëve “Besim Rexhepi” e “Rizah Matoshi” punimet për të cilat kanë filluar.

Qeverisja jonë, ka ideuar dhe projektuar edhe ndërtimin e rregullimin e sheshit nga rrethrotullimi i rrugës “Madeleine Albright” deri tek Teatri i Qytetit, një shtojcë kjo e sheshit qendror të Ferizajt, që i shton për mijëra metra hapësirat e reja publike për ferizajasit dhe mbi të gjitha i jep hove të reja zhvillimi bizneseve në atë zonë.

Në këtë kuadër, ditë më parë nisi edhe projekti për rikonstruktimin e rrugës “Naim Beka” në Ferizaj deri në Pleshinë, projekt ky në bashkëpunim me Ministrinë që i jep fizionomi të re e krejt moderne kësaj arterie të rëndësishme rrugore.

Po kështu, në orientimin tonë investimor e që po realizohet është edhe asfaltimi i rrugës “Cen Dugolli” dhe “Brigada 161” ish rruga e “Reçakut” nga Policia e deri tek rruga “Driton Islami” që paraqet një model në ndërtimin e infrastrukturës rrugore, pa lënë anash edhe punën tonë të përditshme si dhe investimet në këtë drejtim, për asfaltimin e zgjerimin e rrugicave të qytetit.

Në këtë projekcion, kemi edhe zgjerimin dhe asfaltimin e rrugës “Agim Ramadani” në zonën rekreative-sportive, pas zhblokimit të procesit nga AKP-ja e po kështu po vazhdojmë me projektin e ndërtimit të rrugës Varosh – Gurëz përgjatë hekurudhës.

Në planin e infrastrukturës rrugore në fshatra, qindra projekte tashmë po realizohen e përbëjnë edhe orientimin tonë investimor për të ardhmen, siç janë: asfaltimi i rrugëve të mbetura në fshatin Pleshinë, asfaltimi i rrugës nga Lagjja Spahia në Greme deri në Varosh, rikonstruktimi i rrugëve kryesore në Prelez të Jerlive, Varosh, Gaçkë, Rakaj.....

.....asfaltimi i rrugës Manastirc- Pleshinë, asfaltim i rrugës Prelez i Jerlive – Prelez i Muhaxherëve, asfaltimi i rrugës Gaçkë – Topojan, asfaltimi i rrugës Muhoc-Sazli, asfaltimi i rrugës Zaskok- Ferizaj.....

.....asfaltimet e rrugëve dhe rrugicave të mbetura në fshatrat: Varosh, Nikadin, Fshat i Vjetër, Rahovicë dhe Talinoc i Muhaxherëve, Koshare, Lloshkobare, Kosinë, Softaj, Cërnillë, Surqinë, Doganaj, Papaz, Sazli, Neredime e Epërme, Balaj, Mirash, Komogllavë, Dremjak, Sojevë, Zllatar.....asfaltimi i rrugicave në Bablak dhe rrugicave të mbetura në fshatin Tërrn, Prelez i Jerlive dhe Muhoc.....

.....asfaltimi i rrugëve në lagjen Sherret dhe “Rizah Matoshi” pa lënë anash edhe zgjerimin e rrugëve, rregullimin e trotuareve, punimet për sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërtimin e kolektorëve për grupe fshatrash, investime këto që përmbushin dhe kompletojnë infrastrukturën për fshatrat e Ferizajt.

Në fushën e shërbimeve publike dhe emergjencë, pas projekteve madhore që përruam ditë më parë si Stacioni i Ri i Autobusëve dhe transporti urban, do të zgjerojmë investimet edhe në rregullimin e vendndaljeve dhe pritoreve moderne të autobusëve.

Në këtë kuadër edhe një mori projektesh të kësaj fushe, vazhdojnë të realizohen si zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik, eliminimi i deponive të mbeturinave, riparimi i rrugëve dhe trotuareve me asfalt dhe kubëza, rregullimi i udhëkryqeve rrugore, rregullimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta, rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe kanaleve ujore si dhe investimet në hidrantë, infrastrukturën nëntokësore në qytet dhe fshatrat e Komunës sonë.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Në planet investimore të fushës së arsimit, kemi vënë fokusin në ndërtimin e kapaciteteve të reja të infrastrukturës shkollore e rrjedhimisht edhe investimet që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e arsimit.

Si të tilla, kemi në përfundim e sipër ndërtesa e reja të shkollave në Neredime, Tërrn si dhe aneksin e shkollës ish “Dr. Shaban Hashani” pa lënë anash angazhimin tonë e projektionin e qartë buxhetor për ndërtimin e objektit të ri shkollos në Manastirc si dhe ndërtimin e anekseve, renovimin e objekteve ekzistuese shkollore si dhe sallave sportive shkollore.

Vargut të objekteve arsimore në Ferizaj iu shtua edhe objekti i dy shkollave të mesme, Gjinnazit “Dr. Shaban Hashani” si dhe Shkollës së Mesme të Mjekësisë “Elena Gjika”, objekt ky me të gjitha standardet më moderne infrastrukturore për zhvillimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Në këtë kuadër, fokusi ynë është edhe investimi në pajisje e mjete më moderne për zhvillimin e mësimin, përmes projektit për rregullimin e kabineteve profesionale dhe pajisjen me mjete laboratorike shkollore, si dhe rregullimin e bibliotekave të reja shkollore dhe furnizimi me tituj të rinj i bibliotekave ekzistuese.

Në fushën e arsimit, vlen të theksohet se Ferizaj është komuna e vetme në gjithë vendin, lidere në gjithë Republikën, sa i përket mbështetjes së studentëve me bursë komunale, ku për të pestin vit me radhë, kemi ndarë bursë për të gjithë studentët aplikues, mijëra sosh.

Në planin e investimeve në shëndetësi, tashmë po merr formën përfundimtare, objekti i ri i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj, bashkëfinancim me Ministrinë, gjersa po kështu, po vijnë punimet me dinamikë të shtuar drejt përfundimit të tyre edhe për objektin e ri të Qendrës së Mjekësisë Familjare Nr.2 si dhe Qendrën e Mjekësisë Familjare në fshatin Koshare, ndërsa si planifikim investimor parashohim ndërtimin edhe të Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Fshatin Rakaj.

Në këtë kuadër, planifikojmë edhe investimet në pajisje laboratorike, mjete pune, investime këto që rrisin cilësinë e shërbimeve shëndetësore për pacientët.

Në projeksionet tona për të ardhme, për të cilën jemi angazhuar për bashkëfinancimin me donatorë është edhe projekti për ndërtimin e Shtëpisë së Pensionistëve, Qendrës Rehabilituese si dhe Qendrës Burimore e po kështu, tashmë kemi ndarë buxhetin për financimet e programeve për mbrojtjen e fëmijëve, kujdesin ndaj të moshuarve si dhe shtëpinë e komunitetit për persona me aftësi të kufizuara.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës!

Një segment i rëndësishëm i qeverisjes sonë është edhe bujqësia. Në këtë fushë, jemi komunë kampione sa i përket mbështetjes së bujqve e fermerëve ferizajas, me pajisje, mjete e sisteme pune që lehtësojnë dhe zhvillojnë punën e bujqve e fermerëve ferizajas.

Në këtë kuadër, po vijojmë me investimet e rëndësishme kapitale siç është projekti për ndërtimin e sillosëve për ruajtjen e grurit, ndërtimin e Qendrës së Panairëve – Hipodromit si dhe rregullimin e Tregut të Kafshëve dhe Strehimores për Qentë Endacak, pa lënë anash edhe investimet tona të vazhdueshme si rregullimi i kanaleve ujitëse, hapja e kanaleve për kullimin e tokave bujqësore si dhe rregullimi i rrugëve të arave me zhavorr.

Në planin e kulturës, rinisë dhe sporteve, përveç mbështetjes financiare për skenën e pavarur artistike, do të vazhdojmë me ndërtimin e kapaciteteve të reja sportive e kulturore, si ndërtimi i fushave të futbollit në Sazli, Saraishtë dhe Dardani, renovimi i Palestrës së Sporteve “Bill Clinton”, ndërtimi i sallës së sporteve për zhvillimin e sportit shkollor në shkollën “Ganimete Tërbeshi”, ndërtimi i fushave sportive në qytet e fshatra, fushat sportive me tarafleks, tribunat në stadiumin “Tefik Çanga” në Tërrn,.....

.....pa lënë anash edhe investimin në ndërtimin e veprave artistike skulpturale, si dhe ndërtimin e Obeliskut kushtuar Kuvendit të Ferizajt të vitit 1908, si kujtesë për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Në sferën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit, Ferizaj është kampion i mbështetjes për bizneset, veçanërisht bizneset e udhëhequra nga gratë, ku qindra prej tyre ndër vite, kanë nisur, fuqizuar e zgjeruar bizneset e tyre, falë mbështetjes nga Komuna.

Në këtë sferë, kemi nisur edhe investimet kapitale si ndërtimi i infrastrukturës në zonën turistike Neredime-Jezerc, ndërtimin e infrastrukturës tek Ujëvara në fshatin Pleshinë, ndërtimin e murit alpin në Jezerc – zonë kjo në projeksionet e punës sonë janë edhe rregullimi i zonës turistike rreth Kalasë së Jezercit si dhe ndërtimi i shtigjeve të ecjes për persona të verbër në Neredime-Jezerc.

Zonja dhe zotërinj!

Anëtarë të Kuvendit të Komunës!

Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028, me projekte të shumta e të shumëllojta, është garanca e zhvillimit të vazhdueshëm të Ferizajt. Duke ju falënderuar për mbështetjen tuaj të vazhdueshëm që i keni dhënë synimit tonë, për më të mirën për Ferizajn e ferizajasit, jam besimplotë se edhe ky dokument, që buron nga qytetarët dhe kërkesat e tyre të sinqerta, do ta gjej mbështetjen tuaj, për të ecur përpara, për Ferizajn që nuk ndalet, për Ferizajn e lartësive të reja.

Ju faleminderit!

Kryesuesi e falënderoj Kryetarin Aliu për këtë prezentim dhe theksoi se e hap debatin për KAB-in:

Brahim Osmani...

Faleminderit i nderuari Kryesues;

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal;

Përfaqësues të ekzekutivit;

Media dhe shoqëri civile;

Të dashur qytetarë të Komunës së Ferizajt;

Sot, jemi mbledhur për të diskutuar Kornizën Afatmesme Buxhetore, dokument që do të duhej ta reflektonte vizionin dhe përkushtimin tonë për zhvillimin e Ferizajt.

Por për fat të keq, ky dokument është vetëm pasqyrë e qartë e dështimeve që si shabllon përcjellët vit pas viti që tregon mungesën e përkushtimit të qeverisjes aktuale ndaj nevojave reale të qytetarëve të Ferizajt.

Pra, ashtu si edhe viteve të kaluara, kemi përsëritje të projekteve dhe shumave të parave që figurojnë vetëm si numra për ta kryer këtë obligim, e jo për të planifikuar vërtetë projekte dhe për t'i realizuar ato.

Flamur Istrefi:

Të nderuar kolegë,

Para nesh kemi Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2026–2028 – një dokument që në letër ka rëndësi të madhe strategjike, pasi i hap rrugë Projektbuxhetit të komunës për vitet në vijim. Por në përmbajtje, kjo Kornizë nuk sjell asgjë të re, përveçse konfirmon mungesën e vizionit, ngecjen kronike të projekteve dhe paaftësinë për t'i përmbyllur ato që janë nisur.

Kjo KAB përsërit skemat e vjetra me:

Projekte që do duhej të ishin përfunduar me kohë, por që ende vazhdojnë të planifikohen për tri vitet e ardhshme;

Projekte të cilat që nga fillimi i mandatit figurojnë në KAB, por që nuk janë nisur kurrë;

Dhe projeksione të reja infrastrukturore për të cilat nuk janë shfrytëzuar as resurset aktuale.

☐ Tek 5 shtyllat që janë bazament i zhvillimit ekonomik,

★ Te shtylla e parë, "Forcimi i ekonomisë komunale", përmendet krijimi i parqeve zhvillimore për bizneset, ndërkohë që në realitet asnjë park nuk është krijuar deri tani.

Gjithashtu, përfshihet edukimi dhe ngritja e vetëdijes kulturore të qytetarëve – një lidhje e pakuptimtë me ekonominë, por edhe një fyerje e heshtur për qytetarët tanë, sikur janë të paedukuar apo të painformuar.

★ Te shtylla e dytë, për shëndetin publik, përmendet ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF-ve, kur në realitet QMF-të ekzistuese po mbyllen – si rasti në Mirash.

Njejtë është edhe Investimi ne mirëmbajtje dhe pajisje mjekësore te reja, kur ju aktualisht ne vend qe t'i furnizoni QMF-të, ju i keni marr pajisjet mjekësore prej tyre sic është rasti me QMF në Fshatin Softaj, QMF që marrin shërbime rreth 5 mije banore të 5 fshatrave te asaj ane, pra i keni marr

→ Aparati i analizave biokimike

→ Rentgeni i dhëmbëve

→ Dhe aparati i oksigjenit elektronik.

Krejt kjo ne arsyetimin qesharak qe e ka dhënë qeverisje komunale duke u thirrur ne situaten globale politike dhe ushtarake.

✦ Në ambient, përmendet parku te stacioni i vjetër i autobusëve, por vetë kryetari ka propozuar dhe ky kuvend e ka votuar qe ai objekt të shfrytëzohet për zyrat e kompanisë "Ambient". Kjo tregon një praktikë tashmë të njohur: një gjë thuhet në publik, dhe krejt tjetër veprohet në realitet.

Nëse i analizojmë shpenzimet:

Kategoria “Mallra dhe shërbime” rritet nga 10 milion në gati 14 milion euro.

Zyra e Kryetarit parashikohet të rritet nga 581 mijë në 751 mijë euro në vitin 2028 – rritje luksi që është e pajustificueshme në raport me nevojat reale të qytetarëve.

Ndërkohë, projektet kapitale – që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve – mbeten të njëjtat, vetëm me shifra të rritura artificialisht, si:

Rruga “Agim Ramadani” (nga 600 mijë në 1.1 milion euro),

Rregullimi i tregut të kafshëve dhe strehimorja për qen (vazhdon të shtyhet deri ne vitin 2028)

Qendra e Panaireve dhe Hipodromi (nga 2026 tani në 2028),

Parku te objekti i ish-pastërtisë – i cili duhet te ishte përfunduar tashme, pritet te përfundoj në Vitin 2028.

Janë disa projekte që çdo vit futen në KAB, vetëm për sy e faqe, pa pasur kur fillim:

Shtëpia e pensionistëve

Rregullimi i tregut të gjelbër

Fusha për futboll në Dardani

Ndërkohë: ndarja e 150 mije eurove për blerjen e Gjeneratorëve për QKMF dhe QMF4 konfirmon edhe një herë për gjendjen e rënd të këtyre ty institucioneve shëndetësore e posaçërisht të QMF 4 për të cilën kam reaguar disa here, QMF ku sa here që ndërpritet rryma, pothuajse behet i pamundur edhe shërbimi për pacient në mungese të gjeneratorit

Te nderuar koleg,

Kjo KAB do duhej të pasqyronte vizionin e kësaj qeverisjeje për mandatin tjetër – por ajo që shihet është mungesë totale e projekteve të reja strategjike.

Përkundrazi, edhe projektet e premtuara janë shtyrë deri në vitin 2028 – pra deri në fund të mandatit të ri, duke nënkuptuar që s'ka më çfarë t'i ofrohet këtij qyteti nga kjo qeverisje.

Në këtë KAB nuk përmendet fare problemi më i madh që e pret këtë komunë: obligimet ndaj përmblyesve, si pasojë e vonësive në pagesat për operatorët ekonomikë, dhe mbi të gjitha kontrata kolektive.

Kryetari aktual jo vetëm që ka dështuar ta adresojë këtë çështje si udhëheqës i komunës, por edhe si Kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës, duke sjellë pasojë edhe për komunat e tjera.

Kjo heshtje e organizuar e qeverisjes lokale në raport me qeverinë qendrore e ka futur komunën në obligime milionëshe, që do të paralizojnë secilin kryetar që do të vijë pas.

Në fund, është e rëndësishme të theksojmë se kjo Kornizë nuk është gjithëpërfshirëse. Disa fshatra vazhdojnë të kenë investime minimale ose aspak, ndërsa investimet përqendrohen në zona të caktuara sipas interesave të ngushta politike. Kjo krijon pabarazi zhvillimore, që nuk i shërben komunës si tërësi.

Prandaj: Kjo Kornizë nuk është dokument zhvillimor. Është një përmbledhje e projekteve të dështuara, e justifikimeve të stërpërsëritura dhe e mungesës së ideve të reja.

Është dëshmi se qyteti ynë po ecën në rreth – dhe se koha për ndryshim nuk është nesër, por ka filluar tashmë

Arian Imeri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se para vetes kemi kab i cili paraqet planifikimin ton financiar i cili lidh planifikimin ton buxhetor i koordinuar me mundësit buxhetore që kemi në si komune, ajo çka është pozitive e kemi një rritje për rreth 7 milion euro qysh në vitin e parë dhe ku vazhdon me një rritje të vazhdueshme edhe në vitet tjera, ku rritja e buxhetit rrit edhe mundësit

e komunës që me i përballu shpenzimet buxhetore, në kuadër të projekteve komunale kemi projekte që janë me rëndësi por edhe projekte që kanë të bëjnë me zhvillimin e qytetit të Ferizajt, dhe kanë rrjedhë edhe nga konsultimet me qytetarë edhe ata të zonave rurale për atë edhe kemi marrë këtë vlerësimin qytetar, përmes këtij dokumenti kemi përcaktu në vija të trasha të gjitha ato projekte si investime publike rini kulturë dhe sport në infrastrukturë, shëndetësi dhe digjitalizim të shërbimeve publike, dhe jemi të vetëdijshëm që kërkesat janë me të mëdha se kaq mirëpo duhet të kemi parasysh që kaq janë mundësit buxhetore, ju ftoj të gjithëve që të kontribuoni me ide dhe projekte eventuale për ta bërë edhe me të mirë këtë kornizë afatmesme, të gjithë e dimë që ujësjellësi ka kalu në nivel qendror, mirëpo për shkak që ska asnjë investim nga lart ne duhet të ndajmë mjete për të mirë të qytetareve për t'i kryer ato punë që sna takojnë tashmë ju faleminderit.

Verona Isaku pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se është pak e dhimbshme kur kryetari flet me entuziazëm për pushtetin e tij, ndërsa qytetarët s'kanë ujë të pijës është non sens kjo punë, Kryetar koncentrohu, stacioni i ka 30-40 ari ja pe bëjmë park ja pe bajm zyre për Ndërmarrjen "Ambienti", s'mujna te dyjat se ska hapësirë.

Ke ba financim për shtëpinë e të moshuarve, cilën shpi t'i jau ke prish, shtëpinë atyre, jau pagunë qaty një qira për lokal sa me ba hajgare me ta.

Tregun e kafshëve ja ke nis me do drona me do video tu naj premtu që së shpejti ka mu lansu e ka me qarkullu, amo ke parapa investime deri në Vitin 2028 d.m.th. deri atëherë s'bohet ajo punë.

Nënkalimi ka mu lansu së shpejti, ndërsa në Vitin 2026 e ke parapa mi nda 1.5 milion d.m.th. ja ki me lansu, ja ki me investu prap në Vitin 2026 d.m.th. këto dyja nuk shkojnë në mes veti, e ke parapa rregullimn e tregut, ndërsa para disa seancave bashkë me asamblëistat e tu e keni pru me privatizu, sa me ta kujtu prap se e di që e ki mbamendjen e shkurtë para disa muajve drejtori yt ka pru investim 3.2 milion euro, kur e pytshmi na çka ke me ba me ato mjete, thojke pi ndajmë na tani, i kqyrim projektet, ndërsa tash paskeni ra në 10 mij euro, paramendo me ra prej 3.2 milion në 10 mij euro, është koga njëfarë difference, ju faleminderit.

Amir Rexhepi pasi përshëndeti të pranishmit ne e dëgjuam me vëmendje kryetarin, mirëpo ajo çka pam është një përsëritje e planifikimit, e që mu më nxitën kolegët me dal këtu, e në veçanti Ariani i cili tha se jemi angazhu, d.m.th. nuk i kanë kry punët veç janë angazhu, sa i përket çështjes së ujësjellësit, kryetari e ka për obligim më ofru shërbime dhe njëra ndër shërbimet është ujësjellësi, pavarësisht që ka kalu në qendër, angazhimi yt si anëtar i kuvendit do të duhej të kryheshin punët ku edhe kryetari ka premtu ujë të pishem, mirëpo mirë që ka planifiku, në Gaçkë p.sh. Greme d.m.th. pas 25 vitesh po flasim për ujë të pijës. Në Fshatin Tërrën ju ke premtu fush sportive, mbaje qat premtim, u dasht p.sh. para se me lëshu trafikun urban me i planifiku pritoret, d.m.th. këtu o ni telashe që veç po ngutesh, se duhet niherë planifikim, e di që videot po të dalin mirë, ani kur pe qonë dronin, mirëpo në praktik qytetarët po hasin në problem, p.sh. në Koshare s'di ku me prit, e përmende infrastrukturën e personave me nevoja të veçanta ju ke premtu kompleks, e s'ke bo sen maden doën syndromin e kishe thirr në takim, noramal, tash të vyejn, se janë zgjedhjet për qata i ke thirr, bile ja kishe nda 3 mijë euro të cilat jau ban vendimin, se pare ski me ju dhanë, po ju thu qe vendimin kur të dalin i merrni, i përmende shkollat kryetar prap këtu u dasht me planifiku për projekte qe i ke nis para 5 vite, p.sh. në Fshatin Tërrn s'janë tu punu, p.sh. o mirë me përfundu at

shkollë edhe Nerodime t'i ske ba kurgja për shkolla, paramendo na s'kem fleta të bardha me printu testin më besoni.

Shkolla "Shaban Hashani" për 8 vjet e ke kry atë shkollë, mirëpo ka mungesë të kabineteve, aty ska kurgja.

Buxheti kolege besoj që e keni pa, po duhet me ja dhanë edhe 1.5 milion vitin tjetër d.m.th. me qeto dy punon Bardhi Linda edhe krejt buxheti po shkon në dy kompani, Drejtori i Shëndetësisë po mungon, këtu unë e kam një rast, këtu ku ka ba kërkesë për subvencionim kryetari, ja ka bo vendimin, po paret s'ja kanë qit, ndërsa personi ka ndrru jetë, e këta hajnë darka, dreka kah 1 mij euro, mirëpo Drejtori i Shëndetësisë ka tjera prioritete, paramendoni kompanit i kanë marr mbi 1 milion euro, e atij s'kanë pas mundësi, 1 mij euro me ja qit.

Besim Haziri, pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se du me livdu pak kryetarin se e pat një fjalim brilant, mirëpo një problem qe i njeiti me vitet e kalume, e pat gojën plot me temë, investim, zhvillim e kesi gjana, mirëpo je shumë me fat qe qytetarët nuk e kanë informacionin e duhur nga afër me pa se si barten projektet po thuajse nga viti parë, uroj që qytetarët ta analizojnë nga afër, sepse kjo pikë dallon, ndoshta vetëm kostumin e ki ndryshe nga seanca para dy viteve.

Mimoza Pajaziti pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi se unë dua vetëm një gjë të them për banorët apo qytetarët e Ferizajt, vijnë e vizitojnë të gjitha qytet përreth prandaj është për mi dhanë duartrokitje, është për mi dhanë dritën jeshile projekteve, e jo vetëm me ba zi edhe qyteti jonë është në zhvillim ku është tu e ndrru komplet imazhin, unë i shikova të gjitha projektet që janë për tu lavdëru, mirëpo e kam veç një kërkesë, ku te shtruarja me zhavorr e rrugëve të arave kërkoj që sa ma shpejt te kem edhe me shumë për të gjithë bujqit, tu mundësohet t'i punojnë arat e tyre dhe kërkoj që të investohet në këtë sallë të kuvendit t'i hjekim fletat e bardha, të kemi kushte ma të mira, të kemi llaptop e gjana elementare për punë, dhe kërkesa tjetër është që banorëve te nënkalmi, personave me karroca një qasje më e mirë dhe të përgëzoj për këto punime.

Lumnije Morina pasi përshëndeti të pranishmit theksoi: s'pari anëtarët e kuvendit nuk o mire me ngatru KAB-in me Raportin e punës, ne sot jemi mbledh me diskutu KAB-in, ky dokument nuk është veç përmbledhje e projeksioneve, por është hartë orjentuese për drejtimin ekonomik, social për zhvillimin e Ferizajt, kjo kornizë strukturohet sipas kategorive ekonomike dhe siguron një balancë në mes nevojave të qytetarëve dhe mundësive buxhetore, duke u bazuar në 5 shtylla kryesore, si shtyllë e parë është marr forcimi ekonomik i asaj komune pasi Ferizaj ka potencial për të qenë një qendër për zhvillim modernë dhe gjithëpërfshirëse me krijimin e fondit për investime dhe punësim, mbështetje për biznese të vogla, mikrofinanca, grat në biznes dhe zhvillimin e parqeve për biznes, synohet jo vetëm rritje ekonomike por edhe punësim të qëndrueshëm dhe drejtësi sociale, lobimi për investime në spitale e rrit qytetin, ndërtimin dhe zhvillimin e qendrave mjekësore, janë dëshmi konkrete për një zhvillim të kësaj fushe.

Shtyllë tjetër që është parapa nga hartuesi i këtij dokumenti është mbrojtja e ambientit me plane për pyllëzim ashtu si e tha kryetari, krijimin e parqeve urbane, investime në "Parkun Liria" pastaj krijimin e liqenit artificial investime në menaxhimin e mbeturinave dhe reciklim, shtyll tjetër është shërbime efikase të shpejta si digjitalizim transparenca buxhetore qasje e hapur në dokumenta, sa i përket arsimit edukimi cilësor është prioritet me theks të veçantë me funksionalizimin e çerdheve,

pastaj kabineteve, rritja e bursave, ku shihet qartë që po përgatiten qartë për tregun modern të kuvendit.

Të nderuar anëtarë të kuvendit, KAB-i 26-28 është dokument vizionar, por edhe praktik edhe paraqet vullnetin tonë për një ferizaj edhe më të zhvilluar, prandaj është momenti që të veprohet me përgjegjësi për t'i dhanë përkrahje këtij projekcioni buxhetor, pasi që secili cent i paras publike shohim se është planifikuar që të shkoj ku ka më shumë nevojë dhe ndikim për të bërë edhe më cilësore jeta e qytetarëve të ferizajt, ju faleminderit.

Ejup Delolli pasi përshëndeti të pranishmit theksoi po të isha unë asambleist i opozitës nuk do të kisha thanë asnjë fjalë për këto projekte, ky vit është vit zgjedhor dhe fitoni bajeni si të doni ky është vizion i PDK-së dhe Kryetarit Agim Aliu, ju falemnderit.

Sylejman Metushi, përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se dua vetëm të replikoj me atë që tha Amiri, të thuhet që pacienti ka ndrru jetë për atë subvencionim s'është e drejtë, e para nëse paska vdekë për mjete pse si ndihmove, kur duhet të dihet që furnizimi me barana është partia juve, ajo që e bënë, s'është korrekte, kjo të thuhet që ka vdekë për që s'ja kanë dhanë 1000 euro, pasi po të ishin në pyetje vetëm 1000 euro, s'do të kishte vdekur askush.

Sadat Ismajli pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se e para për me ditë që e kem serioz, unë kam qenë në diskutim publik me qytetar, por ju s'keni qenë me kërkë dhe me pas ardhë me thanë kërkë që të futet ky projekt dhe nëse ka dikush diçka që ka qenë me kërkë dhe nuk është futur në këtë KAB, atëherë ngritne dorën edhe tregoni se çka është ajo.

E dyta u përmend që ka ardhë kopy past, ku keni pa bre stacion në qendër, është mirë t'i përmendim do gjana pozitive siç janë: stacioni, nënkalmi, çerdhe është hap nja në Fshatin Greme, apo qeveria sa ka mjete se ka ba asnjë në Ferizaj, u përmend "Ambienti", unë me sa e di që ka mu ba zonë e gjelbërt te stacioni, është projekti, u përmend që shlyqyr që se dinë qytetarët qfar kryetari kem, ndërsa unë besoj që ska qytetar që se njeh kryetarin nga afar, pasi është i qasshëm, unë e di që është vit zgjedhor po thuni, ato që me vërtet i keni me zemër, thuni që këtë projekt e kam pru po shkaku që jam i këtij fshati, e i kësaj partie, t'i se ke fut, ndërsa këto çka po thuni s'kanë hiç bazë, ju faleminderit.

Kryesuesi pasi ska të tjerë për diskutim, para se me ja dhanë fjalën kryetarit edhe njëherë replika nga ata që kanë kërkë:

Besim Haziri, Sadat mirë është me ngu me vëmendje, projekt që është ba prej 2017, kërkesë, kurr se ka marr parasysh, është t'i e din me pronën në Zaskok, tjetër nëse je kanë në Pleshinë nga Fshati Dubravë, unë s'besoj që mundësh me kalu pa i mbyll hunt edhe pse kjo kërkesë u ba nga Ejup Delolli, çka ki me fol për stacion, t'i nuk udhëton me autobus për me pa që ka deshtu aj projekt, veti qytetart, neve na duhet me marrë mendime nga ata që presin në trotuar, pasi ska pijetore, lej t'i dronat, fotografit e videot, ndërsa realiteti është tjetër.

Brahim Osmani, u përmend disa projekte shitesat për fëmije, ku jemi e vetmja komunë që s'bëjmë çerdhe, asnjë se ka ba kryetari, pishinën olimpike su ba, rregullimi i trotuarit në Fshatin Softaj, Pojatë su ba, unë Sadat e kam frigën që edhe qato që janë ba nga organizatat tjera janë tu ja marr, p.sh. QMF në Fshatin Softaj, e gjithë operatura u marr, transporti urban është dështim, a

e di çka ju kanë thanë kompanive hajde t'ia bajmë kështu, e ta kqyrim a funksionon, a e dinë sa linja janë në transport urban, ujësjelli në Fshatin Sojev, Mirosalë etj. andej unë spo tham që ska bifurkacioni përgjegjësi, po pe tham që 4 vjet në këtë kuvend e kanë shkru veq projekti, po su përfundu kurr anej.

Amir Rexhepi, doktor unë po të them që kur po vjen kryetari po mundohesh edhe t'i me tregu vetën, je profesionist, je mjek, po unë po ta shpjegoj kështu, kabineti subvencionon me smundje të kancerit, ky ka ba kërkesë, ju ka miratu vendimi, po s'ju ka ba pagesa, po përgjatë kësaj periudhe këta kanë ba pagesa milionshe, pse s'ju ka pagu këtij zotnisë, a i kam ndihmu unë, a si kom ndihmu, ajo është çështje private s'boj filma unë.

Flamur Istrefi pas diskutimeve tona një pjesë e asambleistëve të pushtetit dolën në kundërshtim me njëri tjetrin, Jupa tha që është vizion i kryetarit, ndërsa Sadati tha janë kërkesa të qytetarëve, në fakt s'është as vizion, e as kërkesa, po janë projekte që dy mandate.

Kolegu tha qe kemi informate që po bëhet një park te stacioni, a në fakt ky kuvend e ka votu për zyre për "Ambientin".

Tjetra tha bjerni kërkesa, tash a o vizion, a kërkesa, se spo dihet, tregu i gjelbërt qysh keni me ba, kur është në të gjitha KAB plus që seancën e kalume ja kemi dhanë "Ambientit" me menagju.

Kanalizimi dhe ujësjellësi duheni me ditë, që kushtet elementare me ja siguru, ndërsa menagjimi është nivel qendror, sa i përket QMF-së ato që i kemi po i mbyllim, si në Softaj ajo gjendje o reale, ju falemnderit.

Ejup Delolli, veç një skjarim Falmur, ngo, janë numrat 26-28 qy sa e qart është, jo për Vitin 2025 Sadati tha bjeri projektet, kjo shqyrtohet prap, analizohet, s'do me thanë që s'mujna me livrit, po t'i as një projekt sje tu e pru, për qeta jeni qetu në miniatur keni me mbetë, ju falemnderit.

Drejtori Meriton Hajdini, merrne lexojeni ligjin edhe kqyrne saktë se përgjegjësi e kujt është uji, mirëpo në Fshatin Zllatar i kemi investim mbi 2 milion euro edhe në Fshatin Rakaj jemi tu punu edhe pse nuk është përgjegjësi e jona edhe në Fshatin Cërnillë merrne kqyrne memorandumën ku janë mbi 1.7 milion nga ne dhe 2 milion nga qeveria 3.7 milion ashtë i gjithë projekti dhe pra s'është investim vetëm i qeverisë, ju falemnderit.

Kryesuesi ia kaloi fjalën Agim Aliut për fund të KAB-it i cili theksoi: të nderuar anëtar të kuvendit falemnderit për debatin pasi është Viti 2025 është i zakonshëm, pasi është vit zgjedhorë, është fat i yni, pasi cinizmit injorancës ju kemi përgjigjur me punë, është një fat që këtë kuvend nuk e këqyrin shumë qytetarët, për ta shikuar se kush, e si e përfaqëson kesi forme të kuvendit, pasi unë kam qenë qysh moti anëtar, kryesues kuvendi dhe kesi përfaqësimi ska pas asnjëherë, uroj që qytetarët të bëjnë një një zgjedhje të duhur këtë vit, pasi që dikur Kuvendi i Ferizajt kishte kualitet të lartë dhe jo nivel si e ka sot. Ka patur figura emblematike ku vishin me propozime konkrete, madje ka pas raste që e kanë rrëzu krejt buxhetin, fatkeqësisht ka kohë që ky kuvend ka rrëshqit nga cinizmi injoranca që veç gjuhë e qytetarëve të Ferizajt nuk është.

Sa e sa herë ne duhet këtu me skjaru që ka probleme të caktuara dhe nga kush është shkaktuar në fakt, unë jam kryetar që më së paku jam ankuar për të kaluarën dhe më së paku e kam përdorur atë çështje për të diskutuar.

Ferizaj ju premtoj që vazhdueshëm do të ndryshoj pasi Ferizaj është qytet modern dhe model pasi këtë e ka bërë Ferizaj edhe për atë që vetë ferizajasit japin shumë në taksa e në gjithçka tjetër dhe kjo s'është më e mira, mirëpo ju e dini që kemi ulur tatimin në pronë në maksimum dhe jo ato lëmosha nga 100 euro çfarë nau propozuan, pasi kemi parime gjithëpërfshirëse, kaheerë jemi mobilizuar për tema madhore, e kemi të kuartë besimin e qytetarëve, p.sh. parku i bizneseve unë s'kam qenë kryetar asokohe, po është 12 h. i Zonës së Babushit, paramendoni qeverisja e kaluar i ka dhanë kontratë një kompanie turke, që kuvendi pastaj e ka rrëzuar, ndërsa në PZHK na e ka lanë, pasi e ka bërë dedikimin në zonë bujqësore dhe ju e dini që PZHK s'mund të ndryshohet, uroj që këtë vit ta rregullojmë këtë çështje.

Jemi tu ndihmu student në master, doktorata, të sëmur, madje ne kemi qenë modest duke mos i publikuar asnjëherë ato pasi ska nevojë edhe pse shumë komuna e bëjnë.

“Stacioni i autobusëve” dështim, pse dështim, a e njehni ju dështimin këtu, a se dini ju kush qeveris këtu, ne se njohim dështimin, i njohim vetëm progreset, sigurisht që janë vështirësi pasi është faza testuese, mirëpo do ta bëjmë më të mirën Ferizaj, është nivel tjetër dhe do të vazhdojmë këtë nivel në aspektin progresiv.

Na enjohim secilin që thoshte populli si parën e kuqe.

Kryesuesi theksoi se pasi përfundoj debati unë e nxjerr në votim këtë KAB, dhe kaloi me 22 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 5-të për varrezat në Fshatin Balaj ku drejtori theksoi se këtë pronë e kanë shfrytëzuar qytetarët për varreza, mirëpo meqenëse është pronë private kemi mendu me ba interes të përgjithshëm dhe më pas të planifikohet në buxhet për pagesë, ju faleminderit dhe kjo pikë kaloi me 23 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikat që kanë të bëjnë me pezullimet e vendimeve 38, 39 i datës 30.04.2025 ku kaloi me 23 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Po ashtu edhe pezullimin e vendimit 26 i datës 28.03.2025 edhe këtu kemi të bëjmë si më lart duhet t'i pezullojmë për shkak që është kohë e zgjedhjeve kaloi me 23 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e propozoi pikën për rregullimin e pagës minimale për ndërmarrjet publike aksionarët dhe kaloi me 23 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e ftoj Faik Selmanin që të prezantoj pikën për vazhdimin e mandatit për komisionin për emërtimin e rrugëve dhe futjen e të dhënave në sistemin ARIS, Faik Selmani theksoi se para një viti veçse ju kam lajmërua që deri në fund të këtij viti planifikojmë që të përfundohet edhe është qëndrim i nivelit qendror dhe nuk do të thotë që do të përmbyllët në Vitin 2025, mirëpo duhet të shikohet një mënyrë për tu funksionalizuar ky komision, gjatë kësaj periudhe po bëhet regjistrimi i adresave në zyrët komunale dhe kjo pjesë duhet me kuptu që duhet mu vazhdu, po ashtu kanë mbet

shumë punë që duhet mu kry, po ashtu çështja e pagesave sa i përket ekipeve kërkoj që t'i shtohet edhe 100 euro për anëtarët dhe çështja e pozicionit të nga ana ligjore është njëjtë për mu kompensuar si tjerët.

Brahim Osmani, unë i kam disa diskutime që kanë ardhë nga qytetarët, janë disa ankesa që janë ndryshu emrat dhe është e rëndësishme që komisioni mos t'i bëjë pa dijenin e tyre në Fshatin Talinoc të Muhaxherve, u ndryshu emri i dëshmorit dhe ka plot raste tjera që janë vendos emra pa u diskutu nga askush, kërkoj që të shikohen mirë këto, pasi janë probleme serioze.

Arian Imeri seriozisht me vjen keq me dal me thanë kur po munohen me manipulu në çdo rast, ky komision ska mandat mi ndrru emrat këto ndryshime kanë ndodhë shumë më herët dhe këta janë tu implementu emrat, që i ka vendos një komision tjetër e i ka votu ky kuvend dhe s'ban me manipulu.

Kjo pikë kaloi me 22 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi theksoi se i kemi edhe dy vendime që duhet mu anulë që janë vendimi me numër 31 dhe 32 i datës 28.03.2024, d.m.th pasi ministria ka kërku që të anulohën për shkak të procedurës së gabuar ligjore.

Kush dëshiron ta merr fjalën, Amir Rexhepi, kryetari ka qenë mirë me ja skjaru të paktën Pakizës që kuvendi nuk emëron dhe nuk propozon për këtë çështje.

Kryesuesi pyeti kush është për anulimin e këtyre vendimeve dhe kaloi me 24 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.


Te pyetje dhe kërkesa kush dëshiron të diskutoj:

Ibrahim Hyseni, pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se kam një kërkesë nga operatorët ekonomik që rruga që vijnë automjetet, autobusët nga Prishtina po duhet me kalu hekurudhën për mu kthy në stacion edhe mu më është dukur e pa nevojshme, kishte qenë më mirë një ndarje fizike aty dhe do ta lejonte komunikacionin, ju sigurisht e keni inxhinierin dhe me dal me këqyrë aty gjenden, me pa sa shumë krijon vështirësi, ju faleminderit.

Amir Rexhepi pasi përshëndeti edhe njëherë të pranishmit theksoi se dua të bëjë një propozim drejtor, ajo pjesë është shumë mirë, mirëpo më ba ndarje publike është kanë mirë me thirr ekspert të komunikacionit, pasi besoj që bëhet rrezik aty.

Kryesuesi pasi konstatoi se nuk ka tjerë për të diskutuar e shpalli të mbyllur këtë mbledhje.

Procesmbajtësi


Leutrim Mahmuti


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ferizaj Xhavit Zariqi